



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR RUMANINË

1. Informacion bazë

- a) Kryqteti: Bukureshti
- b) Popullsia: 22,303, 600
- c) Sipërfaqja: 237,500 km²
- d) Monedha: Lei
- e) Niveli i papunësisë: 6.2%

2. Kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe informacion për vizat

Informacion i përgjithshëm

Nëse udhëtoni për në Rumani, duhet të aplikoni për vizë pranë një misioni diplomatik apo zyre konsullore rumune. Përrjashtim bëjnë ata shtetas nga vende me të cilat Rumania ka nënshkruar marrëveshje për heqjen e vizave ose ka hequr vizat në mënyrë të njëanshme.

Shtetasit nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia kanë nevojë për vizë për të hyrë në Rumani.

Viza rumune lëshohet nga misionet diplomatike apo zyrat konsullore rumune në vendet përkatëse. Viza për qëndrim afatgjatë jepet nga misionet diplomatike apo zyrat konsullore rumune, me miratimin e Qendrës Kombëtare Rumune për Vizat, vetëm pasi është dhënë miratimi nga Zyra Rumune e Imigracionit. Zyra Rumune e Imigracionit e jep miratimin brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për vizë nga Ministria Rumune e Punëve të Jashtme. Vizat për qëndrim afatgjatë për të huajt që janë pjesëtarë familjeje të shtetasve rumunë përjashtohen nga tarifat konsullore.

Vizat mund të lëshohen me një ose më shumë hyrje. Vizat për qëndrim të shkurtër dhe ato tranzit, në raste të veçanta, mund të lëshohen nga zyrtarët kufitarë, në pikat shtetërore të kalimit kufitar.

Llojet e Vizave

1. *Vizat tranzit aeroportuale, simboli A;*
2. *Vizat tranzit, simboli B ose B/CL në rastin e grupeve - (vizë kolektive);*
3. *Vizat për qëndrim të shkurtër, të identifikuar nga njëri prej simboleve të mëposhtme, sipas llojit të veprimtarisë që aplikanti do të kryejë në Rumani:*

- mision (**simboli C/M**)
- turizëm (simboli C/TU ose CL/TU, në rastin e grupeve);
- vizitë (**simboli C/VV**);

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



GOVERNMENT
OF LIECHTENSTEIN

- tregti (**simboli C/A**);
- transport (**simboli C/TR**);
- sport (**simboli C/SP**);
- veprimtari kulturore, shkencore dhe humanitare, trajtim mjekësor afatshkurtër ose veprimtari të tjera që nuk janë në kundërshtim me ligjin rumun (**simboli C/ZA**).

4. *Vizat për qëndrim të gjatë*, të identifikuar nga njëri prej simboleve të mëposhtme, sipas llojit të veprimtarisë së aplikanti do të kryejë në Rumani:

- aktivitet ekonomik (**simboli D/AE**);
- aktivitet profesional (**simboli D/AP**);
- aktivitet tregtar (**simboli D/AC**);
- kontratë pune (**simboli D/AM**);
- studime (**simboli D/SD**);
- bashkim familjar (**simboli D/VF**);
- të huaj të martuar me shtetas rumunë (**simboli D/CR**);
- aktivitet fetar ose humanitar (**simboli D/RU**);
- qëllime të tjera përveç atyre më sipër (**simboli D/AS**);
- vizë diplomatike dhe për shërbim zyrtar (**simboli DS**).

Vizat janë të vlefshme dhe i mundësojnë personit qëndrimin në territorin e Rumanisë për:

- 90 ditë, me mundësinë e zgjatjes brenda territorit, në rastin e vizave për qëndrim të gjatë;
- deri në 90 ditë, pa mundësinë e zgjatjes brenda territorit, në rastin e vizave për qëndrim të shkurtër;
- 5 ditë nga data e hyrjes, në rastin e vizave tranzit.

Tarifat për viza

- Vizat zyrtare dhe afatshkurtëra:

- një hyrje - 25 dollarë amerikanë
- shumë hyrje - 60 dollarë amerikanë

- Vizat tranzit:

- një kalim (dhe për një tranzit aeroportual) - 15 dollarë amerikanë
- dy kalime (dhe për dy tranzite aeroportuale) - 25 dollarë amerikanë

Për të marrë vizë në kohë të përshpejtuar (brenda 48 orëve) ka një tarifë shtesë prej 6 dollarësh amerikanë. Kostot e mundshme shtesë për shërbime të tjera konsullore caktohen sipas rastit.

Më shumë informacion për procedurat e vizave dhe formularët e aplikimit të cilët mund t'i shkarkoni nga:

<http://www.mae.ro/index.php?unde=doc&id=7201&idlnk=3&cat=5>

Për adresat e ambasadave rumune shikoni seksionin 14.

3. Imigracioni për qëllime punësimi

a) kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj

Shtetasit e vendeve jo-anëtare të ZEE-së lejohen të punësohen në Rumani me kusht që të sigurojnë një autorizim për punë dhe një vizë pune/leje qëndrimi.

Autorizimi dhe viza për punë

- Qëndrim afatshkurtër

Hapat e përgjithshme të procedurës së aplikimit për autorizimin për punë janë si më poshtë:

- punëdhënësi, në emër të punëtorit migrant, siguron miratimin e Zyrës së Imigracionit
- punëtori migrant siguron një vizë për qëndrim afatgjatë
- punëtori migrant siguron një autorizim për punë
- punëtori migrant nënshkruan një kontratë individuale pune me punëdhënësin
- punëtori migrant siguron një leje qëndrimi të përkohshme

Vizitorët tregtarë afatshkurtër përjashtohen nga kjo procedurë. Në vend të kësaj, ata duhet të aplikojnë për një vizë tregtare afatshkurtër (vizë C/A). Kjo vizë u lejon shtetasve nga vende jo-anëtare të ZEE-së të hyjnë në territorin rumun dhe të qëndrojnë (ose të hyjnë disa herë) për një periudhë maksimale prej 90 ditësh. Në rastin e punëtorëve që udhëtojnë shpesh për në Rumani për marrëdhënie bashkëpunimi tregtar, mund të lëshohet vizë qëndrimi të shkurtër me disa hyrje për 12 muaj. Megjithatë, kohëzgjatja e përgjithshme e qëndrimit nuk mund të kalojë 90 ditë brenda gjashtë muajve.

Kategoritë e mëposhtme të punëtorëve migrantë plotësojnë kriteret për viza tregtare: personat që udhëtojnë drejt Rumanisë për qëllime ekonomike dhe/ose tregtare, për kontrata ose marrëveshje, për të mësuar apo verifikuar përdorimin dhe funksionimin e mallrave që sigurohen ose shiten në bazë të kontratave të bashkëpunimit tregtar dhe industrial. Dokumentet e mëposhtme duhet të dorëzohen personalisht pranë misionit diplomatik rumun në vendin e qëndrimit të punëtorit migrant:

- formulari i kërkesës për vizë
 - pasaporta
 - prova të sigurimit të udhëtimit apo sigurimit mjekësor që mbulon shpenzimet për aksidente ose ato spitalore, të vlefshme për të gjithë periudhën e qëndrimit në Rumani
 - prova të fondeve të mjaftueshme për të gjithë periudhën e qëndrimit në Rumani (të paktën 100 dollarë amerikanë në ditë)
 - letër reference lëshuar nga shoqëria që e dërgon personin dhe nga shoqëria rumune që vërteton qëllimin e udhëtimit
- Qëndrimi afatgjatë

Përsa i takon punësimin në rastin e qëndrimit afatgjatë, procedura është më e komplikuar.

Punëdhënësi i ardhshëm kërkon miratimin e Zyrës së Imigracionit. Ai/ajo duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- prova në lidhje me kryerjen një aktiviteti të ligjshëm në territorin rumun
- prova që vërtetojnë mungesën e detyrimeve në lidhje me taksat dhe sistemin e sigurimit shoqëror
- informacion në lidhje me punëtorin migrant (kualifikimet profesionale, detajet e kontratës së punës që do të nënshkruhet, dëshmi penaliteti, analiza mjekësore)

Miratimi jepet nëse plotësohen dy kushte. Së pari, nuk duhet të ketë asnjë shtetas rumun ose të ZEE-së që plotëson kriteret apo që dëshiron të punojë në një pozicion të caktuar. Së dyti, punëtori migrant duhet të përmbushë të gjitha kriteret në lidhje me kualifikimet profesionale dhe përvojën e nevojshme për të kryer një detyrë të caktuar.

Pasi është marrë miratimi, punëdhënësi ia përcjell atë punëtorit migrant i cili mund të fillojë procedurën e aplikimit për vizë qëndrimi afatgjatë. Dokumentet që nevojiten janë si më poshtë:

- një pasaportë e cila është e vlefshme për të paktën gjashtë muaj pas periudhës për të cilën është kërkuar viza
- një formular aplikimi, i plotësuar dhe i nënshkruar
- dokumente që justifikojnë qëllimin dhe kushtet e udhëtimit, psh. në rastin e punonjësve, miratimi i aplikimit për autorizimin për punë.

Vizat për qëndrim afatgjatë jepen nga misionet diplomatike dhe zyrat konsullore rumune. Procedura mund të zgjasë deri në 30 ditë pasi aplikimi duhet të miratohet nga Ministria e Punëve të Jashtme. Punëtori migrant aplikon për vizë në vendin e tij/saj të qëndrimit. Viza për qëndrim afatgjatë është autorizimi për qëndruar në territorin rumun për një periudhë kohe deri në 90 ditë. Nëse kontrata e punësimit e punëtorig migrant është me gjatë se 90 ditë, ai/ajo mund të kërkojë zgjatjen e saj pranë Zyrës së Imigracionit pas regjistrimit në Rumani. Në varësi të llojit të vizës afatgjatë që i është dhënë punëtorig migrant, personi që e ka këtë vizë mund të kryejë si më poshtë:

- aktivitet ekonomik (psh. sipërmarrje) (D/AE)
- aktivitet profesional (psh. mjek ose infermier, me kusht që kualifikimet e tij/saj zyrtare të jenë miratuar në Rumani (D/AP)
- aktivitet tregtar (psh. aksioner ose partner i shoqërive që operojnë në Rumani) (D/AC)
- punë mbi bazën e një kontrate individuale pune (psh. punonjës i një shoqërie me bazë në Rumani ose punonjës i shoqërive të huaja që kanë zyra në Rumani) (D/AM).

Autorizimet për punë (*Autorizatie de Munca*) lëshohen nga Zyra e Imigracionit në Ministrinë e Punës, Solidaritetit Social dhe Familjes për arsyet e mëposhtme:

- punësim mbi bazën e një kontrate pune individuale ose vetë-punësim
- transferimin e një punëtorig migrant në Rumani nga shoqëria e tij/saj.

Autorizimet për punë lëshohen për një periudhë 12-mujore me mundësinë e zgjatjes (periudha të njëpasnjëshme 12-mujore) vetëm pasi të jetë lëshuar një vizë për qëndrim afatgjatë për qëllime punësimi. Ndalohet përdorimi i autorizimit për punë të lëshuar për punësim me një punëdhënës të caktuar, për të kryer punë me një tjetër punëdhënës, edhe nëse autorizimi për punë është ende i vlefshëm. Në këtë rast, duhet paraqitur aplikim për një autorizim të ri për punë.

Kategori të caktuara të punëtorëve migrantë përjashtohen nga detyrimi për autorizim për punë. Këta janë, ndër të tjerë, shtetas të vendeve jo-anëtare të ZEE-së të cilët kryejnë aktivitete shkencore, artistike ose kategori të tjera aktiviteteve specifike për periudha të përkohshme në një institucion rumun, mbi bazën e një urdhëri nga ministri përkatës.

Për më tepër, nuk nevojiten autorizime për punë kur një shtetas i një vendi jo-anëtar të ZEE-së transferohet nga një shoqëri e huaj (e vendosur në një vend anëtar të Organizatës Botërore të Tregtisë) pranë një dege ose filiali në Rumani. Kushtet janë që si shoqëria mëmë jo-rumune, ashtu edhe dega apo filiali rumun të kenë të njëjtin objekt veprimtarie, si dhe që punëtorig migrant të mund të vërtetojë se ai/ajo nuk punon për subjekte të tjera rumune. Autorizimi për punë nuk është i nevojshëm as në rastin kur punëtorig migrant transferohet nga një shoqëri e huaj tek një subjekt rumun mbi bazën e një kontrate shërbimesh ndërmjet dy shoqërive. Në të dyja rastet, heqja e autorizimit për vizë, nuk e përjashton punëtorigin migrant nga detyrimi për të marrë miratimin e Zyrës së Imigracionit.

Shtetasit e huaj mund të caktohen për të punuar pranë një shoqërie rumune për një periudhë maksimale prej 12 muajsh brenda pesë vjetëve. Ky kufizim nuk vlen për shtetasit e vendeve jo-anëtare të ZEE-së të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të nevojshëm në projektet që janë në proces në Rumani dhe që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të Rumanisë.

Si rregull, kushti për të siguruar autorizimin për punë është marrja e vizës për qëndrim afatgjatë, që, nga ana tjetër, lëshohet vetëm pasi aplikimi për autorizimin për punë të miratohet zyrtarisht. Kategori të caktuara të migrantëve nuk kanë nevojë të sigurojnë vizë qëndrimi afatgjatë për të marrë autorizimin e punës (ata përfitojnë viza për arsye lidhjesh fisnore). Ka, ndër të tjera, edhe shtetas të vendeve jo-anëtare të ZEE-së që janë pjesëtarë familjesh të shtetasve rumunë ose shtetasve që banojnë në Rumani.

Pasi të jetë lëshuar autorizimi për punë, punëtorig migrant është i lirë të nënshkruajë kontratën e punësimit me punëdhënësin e tij/saj në Rumani. Shtetasit nga vende jo-anëtare të ZEE-së mund të lidhin kontrata vetëm për një afat të përcaktuar, i cili nuk e kalon afatin kohor të lejes së punës. Punëdhënësi është i detyruar të nënshkruajë kontratën brenda dhjetë ditëve nga lëshimi i autorizimit për punë. Më pas, punëdhënësi e regjistron atë pranë Inspektoriatit Territorial të Punës.

Leja e qëndrimit

Shtetasit nga vende jo-anëtare të ZEE-së që kanë autorizim për punë dhe vizë qëndrimi afatgjatë, janë të detyruar të regjistrohen pranë Zyrës së Imigracionit (brenda pesë ditëve pas mbërritjes në Rumani). Pasi ka marrë pasaportën me vizë, autorizimin për punë, si dhe informacionin në lidhje me strehimin e punëtorit migrant në Rumani, Zyra lëshon një leje qëndrimi të përkohshme. Nëse puna në Rumani e një shtetasi nga një vend jo-anëtar i ZEE-së zgjat nga 90 ditë deri në 12 muaj, atij/asaj i lëshohet një leje qëndrimi që mbulon kohën e punësimit. Nuk nevojitet leje qëndrimi nëse kontrata e punësimit të punëtorit migrant nuk është më e gjatë se 90 ditë.

Punëtori migrant i plotëson kriteret për leje qëndrimi të përhershme vetëm nëse ai/ajo ka vendosur banimin në territorin rumun. Vendosja e banimit është e mundur pasi punëtori migrant ka qëndruar në mënyrë të vazhdueshme të paktën:

- tre vjet në rastin e shtetasve nga vende jo-anëtare të ZEE-së të martuar me shtetas rumunë
- gjashtë vjet për kategoritë e tjera.

Nëse autorizimi për punë i punëtorit migrant është zgjatur (dhe statusi i tij/saj në Rumani nuk ka ndryshuar, psh. duke u martuar me një shtetas rumun), ai/ajo plotëson kushtet për zgjatur lejen e qëndrimit të përkohshëm pa pasur të drejtë për statusin e personit me qëndrim të përhershëm.

Shtetasit nga vende jo-anëtare të ZEE-së që kanë leje qëndrimi, plotësojnë kriteret për të aplikuar për bashkim familjar pranë Zyrës së Imigracionit. Kjo e drejtë vlen për bashkëshortët/et dhe të miturit, por jo për fëmijët e martuar. Ata duhet të aplikojnë për autorizimet e tyre për punë, pavarësisht nga të drejtat e personit kryesor.

b) sektorët e tregut të punës që po përjetojnë mungesa

Rritja e madhe ekonomike dhe migracioni i gjerë i krahut të punës drejt Evropës Perëndimore ka krijuar mungesa në krahun e punës në shumë sektorë të ekonomisë në Rumani. Sektorët kryesorë që përjetojnë mungesa janë: kujdesi shëndetësor dhe shërbimet sociale personale, ndërtimi dhe bujqësia.

c) faqe elektronike për të kërkuar punë

<http://www.findjob.ro/> (në gjuhën rumune)
<http://www.1job.ro/english/>
http://www.jobbank.ro/jobseekers/jobseeker_index.php
<http://romania.jobs.com/>
<http://www.jobsearch.ro/index.cfm>
http://europa.eu/youth/working/finding_a_job/index_ro_en.html

4. Imigracioni për qëllime studimi

Sistemi i arsimit të lartë rumun administrohet nga Ministria e Arsimit, Kërkimit dhe Rinisë (MECT) (www.edu.ro).

Ky sistem organizohet në tre cikle të studimeve universitare dhe pasuniversitare:

- Cikli i parë (*licenta*) që i korrespondon diplomës së shkollës së lartë
- Cikli i dytë (*master*) /specializimi që i korrespondon diplomës master
- Cikli i tretë që i korrespondon doktoraturës

Departamenti i Marrëdhënieve Kulturore, Arsimore dhe Shkencore (DRCES) në Ministrinë e Punëve të Jashtme Rumune (MAE) bashkëpunon me MECT për organizimin e shkëmbimeve arsimore dhe vazhdimin e shkollimit universitar.

Shtetasit e huaj mund të studiojnë në Rumani në gjuhë të huaj (nëse universiteti e ofron këtë mundësi) ose në gjuhën rumune, me një vit përgatitor për mësimin e gjuhës.

a) Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit për studentët

Studentët ndërkombëtarë që dëshirojnë të studiojnë në Rumani mund të aplikojnë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kërkimit ose pranë universitetit rumun që kanë zgjedhur, për të siguruar Letrën e Pranimit.

Dokumentet që kërkohen për aplikim janë si më poshtë:

1. Formulari i aplikimit; *versioni pdf* [[download](#)]; *on-line version*

2. Kopje e noterizuar e diplomës të shkollës së lartë ose të barasvlershme – për studimet universitare
3. Kopje e noterizuar e certifikatës së diplomimit – për aplikantë të diplomuar ose ata që kanë përfunduar doktoraturën
4. Lista e notave të përkthyer në gjuhën rumune, angleze, franceze ose gjermane
5. Certifikata e gjuhës
6. Kopje e noterizuar e certifikatës së lindjes
7. Kopje e noterizuar e pasportës
8. Vërtetim mjekësor

Formularët e aplikimit mund të gjenden pranë Zyrave të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Ministrinë e Arsimit dhe Kërkimit ose në universitetet rumune, ose në ambasadat rumune në vendet e tjera. Një kopje e dokumenteve të aplikimit duhet t'i dërgohet me postë universitetit të zgjedhur ose Ministrisë së Arsimit dhe Kërkimit për të siguruar deklaratën e pranimit. Origjinali i dokumenteve zyrtare duhet të dorëzohet personalisht kur aplikoni në Rumani.

Përpara se të vijnë në Rumani, studentët ndërkombëtarë duhet t'i kenë dokumentet të miratuara nga ambasadat rumune në vendet e tyre; më pas, ata duhet të sigurojnë një vizë të vlefshme për të studiuar në Rumani (për më shumë informacion, shikoni seksionin e vizave).

Pranimi në institucionet e arsimit të lartë bazohet në përzgjedhjen e dosjeve të aplikimit. Për të aplikuar për studime për arkitekturë, arte dhe sporte, studentët ndërkombëtarë duhet të paraqesin dokumentet e tyre.

Dosja e aplikimit duhet të dërgohet në Rumani brenda datës 15 shtator (për studimet universitare dhe pasuniversitare), ndërsa për aplikantët për doktoraturë nuk ka afat kohor. Fakultetet e mjekësisë kanë dy afate kohore për studimet pasuniversitare: 30 nëntorin dhe 31 marsin.

Studentët ndërkombëtarë duhet të vërtetojnë se njohin mirë gjuhën në të cilën do të zhvillohet mësimi (gjuhën rumune, angleze, franceze ose gjermane). Për studentët të cilët nuk e plotësojnë këtë kriter, ka departamente të specializuara ku ata mund t'i përmirësojnë aftësitë e tyre të gjuhës.

Zakonisht, studentët ndërkombëtarë mësojnë gjuhën rumune gjatë vitit përgatitor. Kandidatët që flasin gjuhën rumune, mund ta kalojnë vitin përgatitor pasi të kenë marrë provimin e gjuhës rumune. Kandidatët, të cilët mund të vërtetojnë se kanë studiuar në gjuhën rumune për të paktën katër vjet të njëpasnjëshëm nuk kanë nevojë të japin testin e gjuhës rumune ose të ndjekin vitin përgatitor.

Vitin përgatitor e organizojnë universitetet e mëposhtme:

1. Universiteti i Bukureshtit "Politehnica";
2. Universiteti i Bukureshtit;
3. Universiteti i Bacau;
4. Universiteti i Cluj "Babes-Bolyai";
5. Universiteti i Konstancës "Ovidius";
6. Universiteti i Craiova;
7. Universiteti i Iasi "Al. I. Cuza";
8. Universiteti i Pitesti;
9. Universiteti i Ploiesti "Oil and Gas";
10. Universiteti Perëndimor i Timisoaras.

Studentët duhet të kalojnë teste gjuhe gjatë vitit akademik, në mënyrë që të kontrollojnë aftësitë e tyre për të folur dhe për të shkruar.

Studentët e huaj, të cilët kanë filluar studimet në vendin e lindjes ose në një vend tjetër, mund t'i përfundojnë studimet në Rumani. Kjo është e mundur rast pas rasti, pas njohjes dhe ekuivalentimit të diplomave. Të diplomuarit e kolegjeve të cilët e kanë një diplomë, mund t'i vazhdojnë studimet e tyre në fakultete të ngjashme që ofrojnë kurse katërvjeçare, pas aplikimit për t'u futur në provimin e pranimit. Nëse e marrin provimin, ata kalojnë drejt në vitin e tretë akademik. Që nga viti 1998, universitetet rumune kanë përfshirë SETK (Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve) i cili lehtëson lëvizjen e studentëve brenda universiteteve evropiane.

Më tepër informacion mund të gjeni në çdo universitet rumun dhe pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kërkimit, Departamenti i Përgjithshëm për Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

b) bursat universitare dhe pasuniversitare

Bursat që ofrohen nga shteti rumun

1. Bursat që ofrohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe në fuqi të bashkëpunimit ose nëpërmjet ofertave njëpalëshe:

- për të huajt që studiojnë në Rumani.

Skema e bursave që ofrohen nga shteti rumun në përputhje me dokumentet dypalëshe në fuqi ose me ofertat njëpalëshe që Rumania i bën shteteve të tjera, administrohen nga Ministria e Arsimit, Kërkimit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Çështjet Evropiane. Për më shumë informacion, shikoni <http://www.edu.ro>

2. Bursat që u ofrohen shtetasve të huaj nga Ministria e Punëve të Jashtme

Shteti rumun u akordon studentëve të huaj 85 bursa nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme – Departamentit të Marrëdhënieve Kulturore, Arsimore dhe Shkencore (DRCES), pavarësisht nga vendi i tyre i origjinës dhe niveli i studimeve. Dosjet e kandidatëve dorëzohen pranë misioneve diplomatike rumune jashtë ose misioneve diplomatike të vendeve të origjinës të akredituara në Bukuresht, të cilat përgjithësisht quhen misione diplomatike.

Një student i suksesshëm i përzgjedhur nëpërmjet kësaj skeme bursash përfiton:

- shkollimin pa pagesë;
- shumën e barasvlershme të 50 dollarëve amerikanë në muaj, për studimet universitare;
- shumën e barasvlershme të 56 dollarëve amerikanë në muaj, për studimet pasuniversitare (diplomat master dhe doktoraturat)

Këto bursa nuk përfshijnë shpenzimet personale dhe transportin ndërkombëtar. Studentët e huaj paguajnë strehimin në konviktet e studentëve universitarë. Ata kanë përparësi në sigurimin e vendeve në konvikte, në bazë të mundësive.

Për më shumë informacion (për afatet, dokumentet që nevojiten, metodologjinë, etj.) shikoni: <http://www.mae.ro/index.php?unde=doc&id=12027&idlnk=&cat=> (në gjuhën angleze)

c) listw e universiteteve dhe kolegjeve kryesore

Universitetet Publike

[University of Agricultural Sciences and Veterinary Medicine of Bucharest](#) (Universiteti i Shkencave Bujqësore dhe Veterinarisë në Bukuresht)

[Technical University of Civil Engineering of Bucharest](#) (Universiteti Teknik i Inxhinierisë së Ndërtimit në Bukuresht)

[Polytechnic University of Bucharest](#) (Universiteti Politeknik i Bukureshtit)

[University of Bucharest](#) (Universiteti i Bukureshtit)

["Carol Davila" University of Medicine and Pharmacy of Bucharest](#) (Universiteti i Mjekësisë dhe Farmacisë "Carol Davila" në Bukuresht)

[Academy of Economic Studies of Bucharest](#) (Akademia e Studimeve Ekonomike në Bukuresht)

[National School of Political Studies and Public Administration of Bucharest](#) (Shkolla Kombëtare e Studimeve Politike dhe Administrimit Publik në Bukuresht)

[National Academy of Physical Education and Sports of Bucharest](#) (Akademia Kombëtare e Edukimit Fizik dhe Sporteve në Bukuresht)

["Transilvania" University of Brasov](#) (Universiteti i Brasovit "Transilvania")

[Technical University of Cluj-Napoca](#) (Universiteti Teknik i Cluj-Napoca)

[University of Agricultural Sciences and Veterinary Medicine of Cluj-Napoca](#) (Universiteti i Shkencave Bujqësore dhe Veterinarisë në Cluj-Napoca)

["Babes-Bolyai" University of Cluj-Napoca](#) (Universiteti "Babes-Bolyai" i Cluj-Napoca)

[Maritime University of Constanta](#) (Universiteti Detar i Konstancës)

[University of Craiova](#) (Universiteti i Craiova)

["Lucian Blaga" University of Sibiu](#) (Universiteti i Sibiu "Lucian Blaga")

[University of Medicine and Pharmacy of Timisoara](#) (Universiteti i Mjekësisë dhe Farmacisë në Timisoara)

[Polytechnic University of Timisoara](#) (Universiteti Politeknik në Timisoara)

["Banat" University of Agricultural Sciences and Veterinary](#) (Universiteti i Shkencave Bujqësore dhe Veterinarisë "Banat")

Universitetet Private

["Vasile Goldis" West University of Arad](#) (Universiteti Perëndimor i Arad "Vasile Goldis")

["Nicolae Titulescu" University of Bucharest](#) (Universiteti i Bukureshtit "Nicolae Titulescu")

["Titu Maiorescu" University of Bucharest](#) (Universiteti i Bukureshtit "Titu Maiorescu")

["Dimitrie Cantemir" Christian University of Bucharest](#) (Universiteti i Krishterë i Bukureshtit "Dimitrie Cantemir")

5. Qëndrimi

Sipas legjislacionit rumun për imigracionin, shtetasit e huaj që qëndrojnë në Rumani për një kohë më të gjatë se 90 ditë në një periudhë gjashtë-mujore duhet të aplikojnë për leje qëndrimi rumune. Leje të ngjashme qëndrimi do t'i lëshohen, sipas kërkesës, edhe pjesëtarëve të familjes (dmth. bashkëshortit/es, fëmijëve) që shoqërojnë personin gjatë qëndrimit në Rumani.

Nëse punësimi i një shtetasi nga një vend jo-anëtar i ZEE-së zgjat nga 90 ditë deri në 12 muaj, atij/asaj i lëshohet një leje qëndrimi e përkohshme që përfshin kohën e punësimit (nuk kërkohet leje qëndrimi nëse kontrata e punësimit e punëtorit migrant nuk i kalon 90 ditët).

Punëtori migrant i plotëson kriteret për leje qëndrimi të përhershme vetëm nëse ai/ajo ka vendosur banimin në territorin rumun. Vendosja e banimit është e mundur pasi punëtori migrant ka qëndruar në mënyrë të vazhdueshme të paktën:

- tre vjet në rastin e shtetasve nga vende jo-anëtare të ZEE-së të martuar me shtetas rumunë
- gjashtë vjet për kategoritë e tjera.

Leja e qëndrimit të përhershëm lëshohet në datën e vendosjes së banimit, për një periudhë pesë-vjeçare dhe mund të zgjatet më pas për të njëjtën periudhë kohe.

Autoriteti përgjegjës për lëshimin e lejeve të qëndrimit është Zyra e Imigracionit.

http://aps.mai.gov.ro/english/index_en.htm

3-5, Eforie Street, Buiding A, 6th floor, district 5, Bucharest

Tel: +40 21-311.88.99

Fax: + 40 21-311.88.95

E-mail: aps@mira.gov.ro

6. Procedura e azilit

Për azil mund të aplikoni pranë:

- Zyrës Rumune të Imigracionit dhe degëve të saj të decentralizuara
- Rojes Kufitare/Policiës
- Policiës Rumune dhe strukturave të saj
- Strukturave të Administratës Kombëtare të Burgjeve

Zyra e Imigracionit në Ministrinë e Brendshme është autoriteti kryesor për azilin.

http://aps.mai.gov.ro/english/index_en.htm

Azilkërkuesi mund ta ankimojë vendimin negativ në gjykatë brenda 10 ditëve pasi ka marrë njoftim.

Azilkërkuesit në Rumani kanë të drejtën e:

- mbështetjes ligjore dhe të një përkthyesi
- këshillimit dhe ndihmës nga OJF-të
- pagesës së përkrahjes ditore, sipas kërkesës
- strehim në strehëz për ata që nuk i përballojnë dot shpenzimet e vetë-strehimit
- kujdes mjekësor dhe në rast urgjencash
- të drejtën për të punuar pas një viti, nëse procedura e azilit vazhdon ende

Personat që kanë marrë statusin e refugjatit kanë të drejtën për punësim, përkrahje sociale dhe strehim për një kohë maksimale prej një viti. Ata kanë gjithashtu të drejtën e bashkimit familjar (bashkëshorti/ja dhe fëmijë të mitur të pamartuar).

7. Bashkimi familjar

Shtetasit nga vende jo-anëtare të ZEE-së që kanë leje qëndrimi dhe personat që kanë fituar statusin e refugjatit kanë të drejtën të aplikojnë për bashkim familjar pranë Zyrës së Imigracionit. Kjo e drejtë vlen për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur të pamartuar. Ata duhet të aplikojnë për autorizime për punë pavarësisht nga të drejtat e kryefamiljarit.

Pranë Zyrës së Imigracionit duhen paraqitur dokumentet e mëposhtme:

- Kopje e lejes së qëndrimit
- Kopje e dokumentit me të cilin pjesëtari i familjes ka kaluar kufirin shtetëror
- Certifikatë martesë/certifikatë lindjeje (e përkthyer dhe e noterizuar) ose dokumente të tjera që vërtetojnë lidhjen familjare, lëshuar nga autoritetet përkatëse.
- Deklarata e aplikantit (e përkthyer dhe e noterizuar) që vërteton marrëdhënien familjare
- Prova të mjeteve financiare
- Prova të strehimit
- Sigurimi mjekësor i aplikantit

8. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor

Kujdesi mjekësor ofrohet sipas kërkesës dhe në rastet e urgjencës. Kujdesi për shtetasit e huaj ofrohet në përputhje me marrëveshjet ndërmjet Rumanisë dhe vendit të tyre të lindjes. Punëtorët e huaj duhet të bisedojnë me punëdhënësit për dispozitat kontraktuale specifike në lidhje me shëndetin.

Fondi i përbashkët kombëtar i sigurimit shoqëror dhe shëndetësor administrohet nga Agjencia Kombëtare e Sigurimit Shëndetësor (CNAS) dhe nga qendrat e saj rajonale. Disa kategori janë të siguruar pa paguar kontribut:

- Fëmijët 18 vjeç ose nën këtë moshë, ose të rinj nën moshën 26 vjeç, me kusht që ata të ndjekin studimet e larta;
- Personat e shtypur politikisht në të shkuarën, veteranët, invalidët dhe vejushat e luftës;
- Personat me aftësi të kufizuara dhe pa të ardhura;
- Shtatzënat dhe gratë që sapo kanë lindur, nëse nuk fitojnë të ardhura ose të ardhurat e tyre janë më të ulëta sesa paga bruto më e ulët në vend.

Sipas ligjit të sipërpërmendur, të gjithë personat e siguruar përfitojnë shërbime mjekësore falas: konsulta mjekësore, receta, si dhe kujdes spitalor bazë.

Ndihma e parë mjekësore mund të jepet nga mjekët e familjes ose nga mjekët e përgjithshëm, ose nga disa partneritete mjekësh, në praktikat e zakonshme apo nga integrimi funksional i praktikave të vendosura në ambiente të ndryshme.

Mjekët e përgjithshëm ofrojnë shërbime mjekësore si për personat e siguruar – regjistruar, ashtu edhe për ata të pasiguruar. Këto zyra ofrojnë kujdes mjekësor bazë, të zgjeruar dhe shtesë, si psh:

- ndihmën e shpejtë në urgjencat mjekësore dhe kirurgjikale;
- ndihmë në situata urgjencash;
- mbikëqyrjen e sëmundjeve kronike: mbikëqyrjen mjekësore aktive për sëmundjet kronike më të shpeshta, recetat për trajtime mjekësore dhe/ose dietike dhe të higjienës, bashkërendimin e kontrolleve periodike nga mjekë specialistë;
- kujdes mjekësor parandalues, si psh: imunizim, mbikëqyrjen e shtatzënave dhe grave që sapo kanë lindur, parandalimin e rrezikut të sëmundjeve për gjendje mjekësore të diagnostikuara, mbikëqyrjen mjekësore aktive për të rritur dhe fëmijë asimptomatikë në rrezik mesatar ose të lartë, sipas moshës dhe gjinisë.

9. Sistemi i sigurimit shoqëror

Të gjithë punëtorët migrantë të punësuar në mënyrë të ligjshme në Rumani kanë të drejtën e standardeve minimale të punës siç parashikohen nga kodi i punës rumun. Këtu duhet theksuar se kontratat individuale të punës lidhen në bazë të vullnetit të palëve, me shkrim, në gjuhën rumune, që mund të krijojë disa vështirësi apo keqkuptime nga ana e imigrantëve që flasin vetëm gjuhë të huaj. Niveli i përgjithshëm i përfitimeve të sigurimit shoqëror në Rumani është i ulët. Mbulimi është shpesh i papërshtatshëm dhe i pjesshëm. Megjithatë këto rrethana, shtetasit e vendeve jo-anëtare të ZEE-së që qëndrojnë përkohësisht në Rumani shpesh nuk plotësojnë kriteret për të përdorur shërbimet shoqërore, përkrahjen publike ose ndihma të tjera. Përkundrazi, shtetasit që qëndrojnë në Rumani për një kohë të gjatë kanë të drejtën e të njëjtave përfitime si shtetasit rumunë, në vijim të kontributit të tyre në fondet e pensionit, shëndetit ose papunësisë. Në varësi të përfitimit specifik, personi duhet të derdhë kontribute për një kohë të caktuar (psh. 12 muaj në 24 muajt e fundit për të kërkuar ndihmën e papunësisë). Për më shumë informacion, shikoni tek Ministria e Punës, Familjes dhe

Udhëzuesin për Mundësitë e Barabarta për Punëtorët e Huaj në Rumani (*Ghidul Lucretorului Strain in Romania*) (në gjuhën rumune)

<http://www.mmssf.ro/website/ro/mobilitate/ghid%20lucrator%20strain%20in%20Romania.pdf>

10. Strehimi

Në përgjithësi, të shtetasit me qëndrim në një vend të huaj jetojnë në të gjithë Bukureshtin dhe në rrethinat e tij. Apartamentet janë mundësia e parë në qytete, ndërsa shtëpitë e veçanta ose gjysmë të veçanta mund të gjenden në periferi.

Strehimi në Rumani mund të jetë shumë i shtrenjtë dhe varion në bazë të llojit të banesës, vendndodhjes dhe standardit të restaurimit. Qiraja mund të jetë nga 500 dollarë për një apartament të vogël në qytet deri në 8000 dollarë dhe më tepër për një shtëpi moderne në rrethina. Monedha vendase është LEU (ROL).

Banesat cilësore (shtëpitë ose apartamentet) po kërkohen mjaft, duke e bërë blerjen e një prone cilësore një proces mjaft konkurrues. Qiratë janë të ngjashme me ato që kërkohen në vendet perëndimore. Qiraja normalisht përfshin shpenzimet bazë si uji, gazi dhe energjia elektrike – disa përfshijnë edhe mobiljet.

Sipas disa ekspertëve, vendet më të mira për të blerë prona janë Bukureshti, Ploiesti, Konstanca, Cluj, Oradea, Brasov dhe Timisoara. Ndërkohë që të huajt mund të blejnë ndërtesa, shtëpi, vila dhe ambiente ngjitur, ata nuk kanë të drejtë të blejnë tokë.

11. Njohja e diplomave

Institucioni përgjegjës për njohjen e diplomave është Qendra Kombëtare për Njohjen dhe Ekuivalentimin e Diplomave në Ministrinë e Arsimit, Kërkimit dhe Rinisë. Qendra njih gjithashtu diploma dhe dokumente studimesh të shtetasve të huaj që kërkojnë leje pune.

National Centre for Recognition and Equivalence of Diplomas Granted Abroad (Qendra Kombëtare për Njohjen dhe Ekuivalentimin e Diplomave të Dhëna Jashtë)

Str. Gen. Berthelot 28-30

Sector 1, 010168, Bucharest

Tel: +40 21 313 26 77, +40 21 405 62 69, +40 21 405 62 44

Fax: +40 21 313 26 77

E-mail: sanda.badulescu@medu.edu.ro

<http://www.cnred.edu.ro/>

12. Shërbimet mbështetëse që u ofrohen migrantëve

ARCA Romanian Forum for Refugees and Migrants (Forumi Rumun për Refugjatët dhe Migrantët)

www.arca.org.ro

Romanian National Council for Refugees (CNRR) (Këshilli Kombëtar Rumun për Refugjatët)

www.cnrr.ro

The Ethnocultural Diversity Resource Center (Qendra e Burimeve të Diversitetit Etnokulturor)

400305 Cluj-Napoca, 21 Țebei St.

Tel: + 40-264-420490

Fax: + 40-264-420491

E-mail: info@edrc.ro

www.edrc.ro

Soros Foundation Romania (Fondacioni Soror, Rumani)

33 Caderea Bastiliei str.
1st District
Bucharest
010613
Tel: +40 21 212 1101
Fax: +40 21 2121032
<http://www.osf.ro>

International Organization for Migration – Romania office (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin – zyra e Rumanisë)
B-dul Dacia 89
Sector 2
Bucharest 020052
Tel:
+ (40)21/211 56 57
+ (40)21/211 45 65
+ (40)21/210 30 50
+ (40)21/212 02 65
Fax: + (40)21/211 44 54
E-mail: iombucarest@iom.int
<http://www.oim.ro/>

13. Marrja e nënshtetësisë

Nënshtetësia rumune mund të jepet me kërkesë të shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi i cili:

- ka qëndruar në territorin rumun të paktën pesë vjet ose nëse është martuar me një shtetas/e rumun/e për të paktën tre vjet;
- provon se ka lidhje me shtetin rumun dhe popullin rumun
- ka mbushur 18 vjeç
- ka mjete ligjore për të përballuar jetesën
- nuk është dënuar në vend ose jashtë për krime që e bëjnë të padenjë për të qenë shtetas rumun
- ka njohuri të mira të gjuhës rumune që e bëjnë të aftë të integrohet në jetën sociale.

Nënshtetësia rumune jepet gjithashtu me lindjen, personave:

- që kanë lindur në territorin rumun, edhe kur vetëm njëri prej prindërve është shtetas rumun
- që kanë lindur jashtë, kur të dy prindërit ose edhe vetëm njëri, ka shtetësi rumune

Organi përgjegjës është:

Ministry of Justice (Ministria e Drejtësisë)
Department of International Relations (Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare)
Str. Apollodor Nr. 17
Sector 5
Bucharest
<http://www.just.ro>

14. Kontakte dhe informacion tjetër i nevojshëm

Ambasada e Rumanisë në Shqipëri
Adresa: Rruga Themistokli, Gjermani 2, Tirane
Tel: 00355-42-56.071
Fax: 00355-42-36.072
E-mail: roemb@adanet.com.al

Ambasada e Rumanisë në Bosnje-Hercegovinë
Adresa: Sarajevo, Str. Samokovje nr.89
Tel: 0038771-615.571
E-mail: rumunska@bih.net.ba

Ambasada e Rumanisë në Kroaci

Adresa: Ul. Srebrnjak nr.150 A, Zagreb
Tel: 00385-1-243.01.37; 00385-1-243.01.38
Fax: 00385-1-243.01.38
E-mail: roamb.cro@zg.tel.hr

Ambasada e Rumanisë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë
Adresa: Rajko Jinzifov nr.42 Skopje, Republica Macedonia
Tel: 00 389-2/3228-055; 3228-057; 3228-058
Fax: 00 389-2/3228-036
E-mail: romanamb@cadis.net.mk
Faqja elektronike: <http://skopje.mae.ro>

Ambasada e Rumanisë në Republikën e Malit të Zi
Adresa: 40 VUKICE MITROVIC Str., Podgorica
Tel: +382 81 618 040 / +382 81 618 041
Fax: +382 81 655 081
Email: ambs.romania.mne@cg.yu

Ambasada e Rumanisë në Republikën e Serbisë
Adresa: Uzicka nr. 10, Dedinje, Belgrad, cod 10400
Tel: 00-38-111-367.57.72
Fax: 00-38-111-367.57.71
E-mail: embassy@romania.org.yu

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Rumani
712 012 Bucuresti, Str.Duiliu Zamfirescu, nr.7, Sector 1
Tel: (0040-1) 211.98.29; 312.22.10
Fax: (0040-1) 210.80.39
E-mail: ambasada_albro@yahoo.com

Ambasada e Bosnje-Hercegovinës në Rumani
Chancery: Stockholm no.12, Sector 1, Bucharest
Tel: (0040 21) 409 26.01
Fax: (0040 21) 409.26.03

Ambasada e Republikës së Kroacisë në Rumani
73 102 Bucharest, Str.Dr. Burghilea, Nr.1, Sector 2
Tel: (0040-21) 313.04.57, 313.03.74
Fax: (0040-21) 313.03.84
E-mail: croemb.bucharest@mvp.hr
Nr. telefoni për Seksionin Konsullor: 313.03.69

Ambasada e Republikës së Maqedonisë në Rumani
Str. Mihai Eminescu Nr.144, Sector 2, 712 182 Bucharest
Tel: (0040-21) 210.08.80
Fax: (0040-21) 211.72.95
E-mail: ammakbuk@rdsmail.ro

Ambasada e Republikës së Serbisë në Rumani
711 321 Bucharest, Calea Dorobantilor nr.34 Sector 1,
Tel: (0040-21) 211.98.71; 211.98.72; 211.98.73; 210.03.59 (protocol)
Fax: (0040-21) 210.01.75
E-mail: ambiug@ines.ro
Seksioni Konsullor: (0040-21) 211.49.80